



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 07 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1439/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI10/19

Parashtrues

Besarta Maloku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 326/18, të 9 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Besarta Maloku (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Ruzhdi Maloku, avokat nga Vushtrria.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 326/18, të 9 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), i cili i është dorëzuar asaj më 20 nëntor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 janar 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 28 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 15 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës KI10/19 dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.
8. Më 10 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative

9. Më 14 nëntor 2016, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (në tekstin e mëtejme: AKSP), shpalli konkurs për pozitën e një mjeku të praktikës së përgjithshme.

10. Më 21 dhjetor 2016, AKSP, shpalli listën e kandidatëve të suksesshëm dhe sipas vlerësimit të komisionit parashtruesja ishte listuar si kandidatja e dytë më e suksesshme, me gjithsej 77% të poenëve të grumbulluara.
11. Më 30 dhjetor 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (në tekstin e mëtejme: KZKA), kundër vendimit të komisionit të AKSP-së për shpalljen e rezultateve.
12. Më 30 janar 2017, KZKA me Vendimin nr. 01/2017 refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtrueses së kërkesës.
13. Më 10 shkurt 2017, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Inspektoratin e Punës, për shkelje të procedurave nga ana e AKSP-së në lidhje me themelimin e marrëdhënies së punës, sipas Ligjit të punës dhe akteve nënligjore në fuqi.
14. Më 21 shkurt 2017, Inspektorati i Punës, me Vendimin nr. XVII-29, aprovon kërkesën e parashtrueses dhe urdhëron AKSP-në ta anulojë Vendimin e AKSP-së nr. 05/2016, gjegjësisht të komisionit përzgjedhës, të 21 dhjetorit 2016 dhe Vendimin nr. 01/2017 të KZKA-së, të 30 janarit 2017, për shkak se nuk ishte vepruar në pajtim me nenin 4, paragrafët (3 dhe 4) të Udhëzimit Administrativ, nr. 14/2011, për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.
15. Më 23 shkurt 2017, AKSP-ja paraqet ankesë në Trupin Ekzekutiv të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kundër Vendimit të 21 shkurtit 2017 të Inspektoratit të Punës, për shkak të konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.
16. Në një datë të pasaktësuar, Trupi Ekzekutiv i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerrë vendim, me të cilin shfuqizon Vendimin nr. XVII-29 të organit të shkallës së parë, duke e kthyer sërish në rishqyrtim çështjen me arsyetimin se është aplikuar gabimisht e drejta materiale.
17. Më 14 mars 2017, Inspektorati i Punës, në bazë të rekomandimeve të organit të shkallës së dytë nxjerrë sërish vendim, dhe përfundimisht e refuzon ankesën e parashtrueses së kërkesës.

Procedura gjyqësore

18. Parashtruesja e kërkesës, më 20 shkurt 2017, kishte ushtruar kërkesëpadi, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar anulimin, si të kundërligjshëm, të konkursit të AKSP-së nr. 5/2016, gjegjësisht vendimin e komisionit për shpalljen e rezultateve të kandidateve.
19. Më 9 qershor 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 75/2017, aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës; anuloi konkursin e AKSP-së nr. 5/2016, të 14 nëntorit 2016; detyroi AKSP-në të rishpallë konkurs në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit dhe urdhëroi të njëjtën që gjatë përzgjedhjes së kandidatëve të merret parasysh përgatitja profesionale e anëtareve të komisionit përzgjedhës.

20. Në një datë të pasaktësuar, AKSP-ja parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të pretenduara të ligjit material dhe procedural.
21. Më 13 qershor 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 3049/2017, refuzoi, si të pathemeltë, ankesën e AKPS-së dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të 9 qershorit 2017.
22. AKSP, në afat ligjor, ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.
23. Më 9 nëntor 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. 326/2018, aprovoi kërkesën për revizion të ushtuar nga AKSP-ja dhe ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, duke refuzuar kështu kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
25. Parashtruesja gjithashtu pretendon se Gjykata Supreme me vendimin e saj ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës për arsye se: *“Udhëzimi Administrativ nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik në nenin 4. 4 ka paraparë: “Së paku tre anëtarë të komisionit duhet të jenë në pozitë më të lartë se pozita që përzgjidhet ndërsa dy anëtarë mund të jenë pozita të barabarta”. Gjykata Supreme e Kosovës, këtë udhëzim administrativ e ka keqinterpretuar sepse kuptimi i kësaj dispozite është e qartë dhe e kuptueshme: tre anëtarë duhen me qenë në pozita më të larta se pozita që përzgjidhet. Në rastin konkret pozita që përzgjidhet ka qenë Mjek i përgjithshëm, ndërsa tre anëtarë të komisionit ka qenë obligative me qenë në pozita më të larta që nënkupton specialistë i mjekësisë, ndërsa dy anëtarë tjerë të komisionit mund të janë në pozita të barabarta me pozitën që përzgjidhet që nënkupton me qenë Mjek i përgjithshëm, sepse në këtë formë do të përzgjidhet kandidati më meritor dhe profesional”.*
26. Për më tepër, parashtruesja pretendon se: *“Qëndrimi i Gjykatës Supreme e Kosovës është në kundërshtim me udhëzimin e lartcekur si dhe në kundërshtim me interesin e përgjithshëm shoqëror, sepse sipas saj doktorin mund ta intervistoj edhe një zyrtar i komunikimit publik apo një zyrtar i divizionit të trajnimeve, të cilët nuk kanë fare njohuri elementare për fushën e mjekësisë dhe kjo është irituese, se si lejohet rekrutimi i tillë”.*

27. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, Rev. nr. 326/18, të Gjykatës Supreme dhe “... *prishjen e të njëjtit aktgjykim duke e kthyer çështjen përsëri në rigjykim dhe vendosje*”.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

30. Gjykata po ashtu i referohet neneve: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

[...]

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në

Gjykatë dhe gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ajo pretendon se i janë shkelur me aktin e kontestuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

32. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës.
34. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendimet për shkelje të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës, vetëm i përmend në kërkesën e saj, por e njëjta nuk elaboron më tej, si dhe pse, ka ardhur deri te shkelja e këtyre dispozitave konkrete.
35. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës, parashtruesja e kërkesës i ndërlidhë me mënyrën se si Gjykata Supreme ka interpretuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe sipas saj qëndrimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me udhëzimin e lartcekur, si dhe në kundërshtim me interesin e përgjithshëm shoqëror.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar dhe vëren se Gjykata Supreme, konkluzionin e saj e arsyetoi, si në vijim: *“... me Urdhëresën Administrative nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, neni 4, par.4 parasheh se: “Së paku tre anëtarë të Komisionit duhet të jenë në pozitë më të lartë se pozita që përzgjidhet ndërsa dy anëtarë mund të jenë në pozitë të barabartë” nga e cila dispozitë del se përbërja e Komisionit i referohet pozitës e jo profesionit, ndërsa në rastin konkret në përbërjen e Komisionit të paditurës ka qenë Drejtori i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të përgjithshme, anëtarë tjetër ka qenë Drejtoresha e Shërbimeve Mjekësore në Policinë e Kosovës (specialiste e internos dhe endokrinologjisë), Udhëheqësi i Divizionit për çështje Ligjore; Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve dhe Zyrtarja e lartë për Komunikim me publik, nga e cila përbërje e komisionit del se, e paditura në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 4, par. 4 të Urdhëresës Administrative të cekur më lart”.*

37. Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtrueses së kërkesës kanë të bëjnë me mënyrën se si Gjykata Supreme në rastin e saj ka interpretuar dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore, andaj, Gjykata konsideron se të njëjtat, në të vërtetë, ngrenë çështje të ligjit (ligjshmërisë) të cilat bien në domenin e gjykatave të rregullta dhe jo të Gjykatës Kushtetuese.

38. Gjykata, ripërsëritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).

39. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, *mutatis mutandis*, rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

40. Gjykata, vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk pajtohet me rezultatin e procedurës. Megjithatë, pakënaqësia e tij me rezultatin e procedurës së përfunduar në gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

41. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës, në baza kushtetuese, nuk i ka mbështetur pretendimet e saj se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

42. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2019, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

